

RAPORT MBI ZBATIMIN E MASAVE LIGJORE KUNDËR DUHANIT 2011

"Studimet tregojnë se njerëzit me të ardhura më të vogla dhe ata me një nivel më të ultë shkollimi, konsumojnë më shumë duhan. Ata janë personat të cilët ndoshta do të kenë edhe pasojat më të rënda, pasi kjo e rëndon gjendjen e tyre ekonomike edhe më shumë."



Financuar nga:



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF
CULTURE YOUTH AND SPORTS
DEPARTAMENTI I RINISË/ DEPARTMAN MLADIH/ DEPARTMENT OF YOUTH

Raport mbi Zbatimin e Masave Ligjore Kundër Duhanit - 2011

Autor i Raportit:

Nehat Bllacaku

Asistentë të Raportit:

Teuta Rexhepi

Esma Islami

Stafi realizues:

Linda Mulolli – Asistente e Projektit

Arta Jakupi - Fotofrafitë

Arbenita Rrmoku - Medoratore

Valmira Zogiani - Trajnere

Raporti është dokument përshkrues mbi aktivitetet anti-duhan gjatë këtyre muajve të 2011. I njëjti shërben si raport për donatorët por edhe si listë mbi aktivitete dhe rekomandime për institucionet dhe grupet tjera të interesit.

Raporti publikohet me aprovimin e Asamblesë së OJQ-së dhe Kryesuesit të bordit.

Të gjitha të drejtat për raportin, por edhe të dhënat e publikuara i barten OJQ-së Mileniumi i Ri me seli në Prishtinë.

Falenderim

Shfrytëzojmë rastin të falënderojmë donatorët: Postën dhe Telekomin e Kosovës PTK Sh.a dhe Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve/Departamentin e Rinisë për mbështetjen pa të cilën nuk do të mund të realizohej ky projekt.

Po ashtu shfrytëzojmë rastin të falënderojmë Dekanin e Universitetit ILIRIA z. Mexhait Reçi dhe Sekretarin e Përgjithshëm z. Arbër Reçi dhe gjithë stafin dhe studentët e universitetit për mbështetjen në organizimin e debatit më 31 maj 2011.

Përmbajtja

Ballina:	1
Pasqyra e Përgatitjes:	2
Përmbajtja:	3
Hyrje:	4
Legjislacioni:	4
Zbatimi i Legjislacionit:	5, 6
Përshkrimi i Raportit:	6
31 Maj 2011 – Zbatimi i masave ligjore kundër duhanit:	6, 7, 8
Trajnimi – Duhani dhe efektet kundër shëndetit:	8, 9
Fakte shëndetësore – DUHANI:	10
Fletushka – Ligji mbi duhanin:	11
Për ne – Mileniumi i Ri:	12
Rekomandimet:	13
Adresa – Fotografi:	14

Hyrje

Përderisa bota gjithnjë e më shumë po bënë përpjekje për zvogëlimin e duhan-pirjes dhe ndalimin e konsumimit në vendet publike, duke vendosur edhe gjopa dhe ndëshkime tjera, në vendin tonë ka ende shumë probleme në këtë drejtim me gjithë përparimet sipërfaqësore.

Legjislacioni

Vendi ynë ka tri ligje përmes së cilave rregullohet çështja e duhanit:

❖ Ligji për duhanin, numër 2005/02-L36 i cili rregullon prodhimin, reklamimin, marketingun, si dhe vend-konsumimin e prodhimeve të duhanit. Ligji krijon detyrim që të kërkohet leje e posaçme për prodhimin dhe importimin e cigareve.

❖ Ligji mbi taksën e zhdrejtë i vendosur mbi prodhimet e duhanit në Kosovë, numër 20023/23, i rregullon taksat e zhdrejta të produkteve të duhanit. Ligji gjithashtu specifikon se autoriteti i përcaktuar, qeveritar Kosovar mund të kërkojë që prodhimet e duhanit të mbajnë vërejtje për dëmtimin e shëndetit në secilën njësi (copë, paketim) dhe që banderola për taksën e zhdrejtë të vihen në secilën njësi të produktit të duhanit si provë e pagesës së taksës së zhdrejtë.

❖ Ligji mbi inspektoratin sanitar (higjienik) të Kosovës, numër 2003/22, i rregullon masat preventive mbi efektet e dëmshme të produkteve të duhanit dhe pirjes së duhanit në vende publike.

Zbatimi i legjislacionit

Në shumë institucione shtetërore dhe private është ndaluar krejtësisht konsumimi i duhanit. Kudo janë vendosur shenja të ndalimit të duhanit dhe janë krijuar hapësira të veçanta ku mund të konsumohet duhani, madje në disa institucione siç është KEK ndërtesa qendrore janë vendosur edhe aparate alarmuese me një njësi të kontrollit në çdo zyre dhe korridore.

Por, përderisa në kryeqytet dhe sidomos në objektet kryesore qeveritare dhe ato të ndërmarrjeve publike dhe agjencive tjera zbatohen rregullat për ndalimin e konsumimit të duhanit, e njëjta nuk mund të thuhet për institucionet dhe ndërtesat qeveritare, ndërmarrjeve publike dhe agjencive tjera në rajonet dhe qendrat me të vogla.

Ekspertët dhe kritikët e duhanit që janë të shumtë dhe vazhdojnë të shtohen nga dita në ditë fajësojnë institucionet qendrore dhe ato lokale për një gjendje të tillë. Siç dihet ligji mbi duhanin parasheh që qeveria duhet të themeloj këshillin profesional për kontrollin e duhanit. Në kohën kur ligji ishte aprovuar kishte një iniciativë ndër-qeveritare për themelimin e këtij këshilli, por ai mbeti vetëm në letër. Në anën tjetër prej dy vitesh Inspektorati Sanitar që ka vepruar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë është vendosur në kuadër të Agjencisë së Veterinës. Sipas ekspertëve kjo ka ndikuar dukshëm në hapat për kontroll dhe vendosjen e gjobave kundër duhanit. Kjo pasi shumë nga inspektorët nuk janë të kënaqur më këtë hap dhe në anën tjetër janë jashtë kontrollit të MSH-së.

Më lart theksuam që megjithëse ngadalë ka përparime në ndalimin e konsumimit të duhanit në vendet publike kryesisht në institucionet shtetërore. Por, sa i përket masave tjera ligjore të ndalimit të pirjes së duhanit në lokalet hoteliere, shitjes përmes auto-aparateve, reklamimit në dyqane të ndryshme, shitjes në rrugë, shitjes në dyqane dhe reklamimin përmes dilerëve në rrugë nuk është bërë pothuajse asgjë.

Pamja e parë në secilin dyqan ushqimor është duhani, megjithëse ekzistojnë shenja të ndalimit të duhanit në restorante, bare dhe kateteri pothuajse askund nuk ndalohet të konsumosh duhanin, në anën tjetër aparatet vetë-shërbyese vazhdojnë të ofrojnë shërbime, fëmijëve nën moshën 18 vjeçare vazhdon të ju shitet duhan, përderisa dhjetëra dyqane mbajnë reklama të markave të ndryshme të duhanit. Një çështje tjetër që vërehet në rrugët e qyteteve tona dhe veçanërisht në Prishtinë është ajo ku të rinj dhe të reja në të shumtën e rasteve nën 18 vjet të ofrojnë dhurata apo ndërrim të markave të duhanit me qëllim të reklamimit dhe shitjes së markave të ndryshme.

Ndërsa ndarja fizike e hapësirave të konsumimit të duhanit në lokalet hoteliere në Kosovë ende është larg nga ajo që parasheh legjislacioni. Ndërsa për të vetëdijesuar opinionin dhe ata që duhet të zbatojnë ligjin duhet të konkretizohen masat. Këto masa janë asgjë më shumë se ato që parasheh ligji; gjobat dhe ndëshkimet tjera.

Zyrtarët e inspektoratit sanitar në Komunën e Prishtinës gjatë prezantimit të punës së tyre në këtë drejtim kanë dhënë 5 qershorin 2011 si datën e fundit ku inspektorët komunal do të fillojnë gjobat dhe ndëshkimet tjera për të gjithë ata që nuk janë duke zbatuar ligjin për duhanin në kryeqytet. Por, sikur edhe në rastet tjera ky është mbeti vetëm premtim meqë asnjë hap nuk po vërehet në këtë drejtim.

Përshkrimi i Raportit

Financuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve/Departamenti i Rinisë (MKRS/DiR) dhe Posta dhe Telekomu i Kosovës (PTK) Mileniumi i Ri ka realizuar projektin “Rini pa Duhan”. Në kuadër të projektit, në ditën botërore pa duhan - 31 Maj 2011 është mbajtur debati, “Zbatimi i Masave Ligjore Kundër Duhanit”. Debati është mbajtur në bashkëpunim me Universitetin ILIRIA, po ashtu në kuadër të projektit është mbajtur trajnimi: “Duhani dhe efektet kundër shëndetit – Krijimi i masës kritike dhe avokuesve të rinj”. Trajnimi është mbajtur në Prishtinë dhe gjatë tri ditëve e kanë ndjekur rreth 60 të rinj nga mbarë Kosova, të cilët janë certifikuar. Në të njëjtën kohë në kuadër të projektit janë blerë dhe shpërndarë më shumë se 80 libra kundër duhanit. Librat janë botuar nga shtypshkronja ALB-Med dhe janë nga seria e librave amerikane “Fakte Shëndetësore”, në të njëjtën kohë në kuadër të projektit është publikuar fletushka në të cilën janë përmbledhur nenet e ligjit mbi duhanin, vendet e ndaluara të konsumimit, ndalimi i shitjes për fëmijët, gjobat dhe aspektet tjera ndëshkimore.



31 Maj 2011 – Zbatimi i masave ligjore kundër duhanit!

Në Ditën Botërore Pa Duhan, 31 maj 2011 u mbajt debati “Zbatimi i Masave Ligjore Kundër Duhanit”. Debati u organizua në bashkëpunim me Universiteti ILIRIA mbajtën debatin me temën “Zbatimi i Masave Ligjore Kundër Duhanit”. Debati u mbajt në ambientet e universitetit. Në cilësinë e panelistëve folën Abdullah Klinaku këshilltar ligjor i ministrit të shëndetësisë, Genc Prelvukaj këshilltar politik i ministrit të kulturës rinisë dhe sporteve, Dr. Jusuf Dedushaj nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Dr. Hafiz Halili shef i inspektoratit sanitar në komunën e Prishtinës dhe Dr. Skënder Syla nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, debatin e moderoi dhe udhëhoqi z. Arbër Reçi Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit ILIRIA.

Në fjalën e tij z. Klinaku foli për përpjekjet që po bëjnë Ministria e Shëndetësisë për të vënë në zbatim ligjin kundër duhan, punën e inspektorëve sanitar, bashkëpunimin me institucionet tjera shëndetësore dhe planet që ka MSH-ja në këtë drejtim.

Ndërkaq z. Prelvukaj u fokusua në punën edukative që vazhdojnë të bëjnë për vite me radhë departamentet e ministrisë së kulturës. Ai potencoi se në kuadër të Departamentit të Rinisë është Sektori për Edukim që është i fokusuar në mbështetjen e OJQ-ve dhe të rinjve kundër dukurive negative. Ai premtoi përkushtimin e mëtejshëm të MKRS-së në vetëdijesimin e të rinjve kundër duhanit dhe dukurive tjera negative.

Më i ashpër në raport me institucionet dhe duhanpirësit u paraqit Dr. Jusuf Dedushaj

Epidemiolog dhe profesorë në Fakultetin e Mjekësisë. Si njëri ndër profesionistët më të vjetër z. Dedushaj përmendi shifra dhe fakte konkrete për dëmet shëndetësore që vazhdon të shkaktoj duhani dhe kjo sidomos tek fëmijët. Ai përmendi edhe sukseset që megjithatë janë arritur me ligjin kundër duhanit, por nuk harroi të thotë që ligji vazhdon të zbatohet sa për të thënë dhe jo për të ruajtur shëndetin e njerëzve ashtu siç është qëllimi i tij. Profesor Dedushaj kritikoi edhe ministrinë e shëndetësisë dhe institucionet tjera për përpjekjet e pakta në luftë kundër duhanit.

Ndërkaq Dr. Skender Syla shef i zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë (OBSH), përmendi shifra të vdekshmëri së në nivel të botës si pasojë e duhanit. Më pas ai përmendi kryeministrin turk, i cili u nderua me çmimin vjetor për mbështetjen dhe përpjekjet e vazhdueshme në luftë kundër duhanit. Shembuj të tillë do të duhej të vinin edhe nga politikanët tanë dhe kjo do të ndikonte edhe te shtresat tjera të shoqërisë.



Më aktiv dhe entuziastë u paraqit Dr. Hafiz Halili shef i Inspektoratit Sanitar në Komunën e Prishtinës. Ai përmendi përpjekjet që ka bërë ky sektor për të zbatuar ligjin. Sipas tij në të gjitha institucionet publike është ndaluar pirja e duhanit, janë larguar billboardet, reklamat dhe shitësit në vendet publike. Por, faktet dhe fotografitë nga përpjekjet e inspektorëve kundër shitësve dhe promovuesve të duhanit shkaktuan shumë pyetje dhe kritika në drejtim të tij. Studentët dhe organizatorët potencuan që çdo ditë hasin të rinj madje nën moshën 18 vjeçare që rrugës të ofrojnë ndërrimin e pakove të duhanit, të ofrojnë pako apo oferta të ndryshme. Por, z. Halili tha që përpjekjet e inspektoratit janë maksimale me gjithë numrin e kufizuar të inspektorëve dhe angazhimet në fushat tjera. Ai potencoi se 5 qershori do të jetë edhe fundi i reklamuesve dhe shitësve publik. Sipas tij nga kjo datë inspektorët do të ndërmarrin aksione kundër atyre që nuk kanë ndarë fizikisht hapësirat, kundër atyre që reklamojnë, promovojnë dhe shesin në vendet publike dhe që nuk përfillin ligjin. Sipas tij do të shqiptohen vërejtje dhe gjoha bazuar në ligjin për duhan.

Debati i zhvilluar në mes panelistëve, organizatorëve dhe studentëve u fokusua në pjesë të ndryshme të ligjit. z. Nehat Bllacaku nga Mileniumi i Ri përmendi disa nga faktet ku ligji është larg zbatimit. Në secilin dyqan pamja e parë është duhani. Përderisa ligji kërkon që hapësira e shitjes së duhanit në dyqane të jetë jo e dukshme për të gjithë dhe kjo hapësirë duhet të shërbej vetëm për shitjen e duhanit, aty duhet të këtë informata mjekësore për dëmet nga duhani, shitësve nuk ju lejohet të ju shesin duhan fëmijëve nën 18 vjet, raste ku duhani shitet përmes formave të vetëshërbimit (Aparate automatike), të cilat me ligj janë krejtësisht të ndaluara dhe raste të tjera.

Trajnimi - Duhani dhe efektet kundër shëndetit!

Në kuadër të projektit më 23 dhe 24 qershor, po ashtu u mbajt trajnimi mbi efektet kundër shëndetit që paraqet konsumimi i duhanit dhe krijimi i masës kritike. Në trajnim morën pjesë 45 të rinjë të ndarë në dy grupe.

Gjatë trajnimit janë shpalosur efektet e dëmshme që paraqet duhani si:

- ❖ Dëmet e drejtpërdrejta dhe ato anësore
- ❖ Vdekshmëria si pasojë e duhanit në nivel të botës dhe rajonit
- ❖ Moshat dhe kategoritë më të prekura
- ❖ Përpjekjet e botës bashkëkohore për të luftuar duhanin
- ❖ Mënyrat e zvogëlimit dhe ndalimit
- ❖ Duhan-pirja pasive

Po ashtu trajnimi u fokusua edhe në mënyrat e avokimit. Kjo me qëllim të krijimit të masës kritike tek të rinjtë në mënyrë që ata të bëhen avokues të së ardhmes. Po ashtu si pjesë e trajnimit janë ligjëruar edhe mënyra e gjetjes së fondeve në luftë kundër duhanit, mënyra e zhvillimit të fushatave, krijimi i ambasadorëve kundër duhanit dhe të tjera. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit kanë mundur të ndjekin edhe një dokumentar kundër duhanit ku përmes imazheve janë paraqitur pasojat që lë për njerëzit dhe ambientin pirja e duhanit.

Pjesëmarrësit janë certifikuar si aktivistë dhe avokues kundër duhanit. Në të njëjtën kohë pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të marrin nga një libër amerikan për pasojat afatgjata që paraqet duhani.

Në të njëjtën kohë Mileniumi i Ri ka krijuar bazën e të dhënave, ku do të ruhet të dhënat e pjesëmarrësve që marrin pjesë dhe certifikohen në vijim të trajnimeve por edhe atyre që aplikojnë në konkurset e ndryshme. Më pas konkurset, ftesat për trajnime, ftesat për grante, ese, fotografi apo çështje tjera me interes ju dërgohen përmes e-mailave të gjithë të rinjve që gjinden në këtë bazë.




Fakte Shëndetësore - DUHANI

Në kuadër të projektit janë blerë 80 libra të serisë “Fakte Shëndetësore – DUHANI”, lbrat janë shtypur nga shtypshkronja “ALB-Med” dhe janë me licencë amerikane. Seritë e tilla të librave janë të shpërndarë në shumë shtete dhe janë përkthyer në gjuhë të ndryshme.

Libri përmban fakte mbi dëmet që paraqet pirja e duhanit si:

- ❖ Shprehia e krijuar,
- ❖ Varësia nga duhani,
- ❖ Ndikimet në sistemin imunitar,
- ❖ Të frymëmarrjes,
- ❖ Të urinës,
- ❖ Kancerit dhe llojeve të tij
- ❖ Sëmundjeve të tjera.





Fletushka – Ligji mbi Duhanin

Po ashtu në kuadër të projektit është publikuar fletëpalosja me nenet e thjeshtësuara të ligjit mbi duhanin. Fletëpalosja është shpërndarë në Prishtinë dhe në zonat rurale.

Në fletushkë janë paraqitur nenet kryesore të ligjit siç janë: vendet e ndaluar të konsumimit të duhanit, ndarja e hapësirave në lokale hoteliere, ndalimi i blerjes së fëmijëve nën 18 vjet, gjobat dhe ndëshkimet që parashihen me ligjin mbi duhanin.

Fletushka të modelit të njëjtë janë publikuar dhe shpërndarë edhe në komunat tjera nga OJQ dhe qendra rinore. Fletushka është shtypur në 2,000 kopje dhe përveçse qytetarëve në rrugë e njëjta është shpërndarë edhe në lokale, kafene, bare dhe restorante të ndryshme në kryeqytet dhe më gjerë. *Pamjet e fletushkës:*



Rekomandimet

Bazuar në aktivitetet e realizuara më lart, por edhe në punën tonë të përditshme kemi nxjerr disa rekomandime dhe konkluzione me të cilat do të duhej marr institucionet qendrore dhe lokale përgjegjëse për këtë fushë:

- ✓ Formimi i këshillit profesional për kontrollin e duhanit. Siç parashihet me ligjin mbi duhanin. Ky këshill duhet të krijohet nga Qeveria, e cila mund të bashkërendoj punën me ekspert dhe ekipe ndërqeveritare dhe me institucione dhe agjenci të pavarura;
- ✓ Kthimi i Inspektoratit Sanitar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe hartimi i një strategjie ndërinstitutionale duke përfshirë edhe nivelin lokal dhe agjencitë e pavarura për zbatimin e masave kundër duhanit;
- ✓ Inspektorati sanitar i komunës së Prishtinës dhe komunave tjera të largoj urgjent reklamimet e duhanit përmes sistemit ndriçues (HD) në kioske dhe dyqane dhe ndalimin e dilerëve ambulantë të reklamimit, në rrugë dhe kafene ku shumica nga ta janë në moshën adoleshente;
- ✓ Zhvillimi i fushatave mediale kundër duhanit me fokus në shkolla dhe institucione tjera arsimore duke përfshirë edhe mbajtjen e një ore ekskluzivisht për duhanin në çdo 31 Maj (në Ditën Botërore Pa Duhan);
- ✓ Planifikimi i vendosjes së sistemeve alarmuese të tymit në institucionet dhe objektet publike;

Për ne...

Misioni

Mileniumi i Ri është organizatë jo-fitimprurëse (OJQ) e themeluar me qëllim të : Fuqizimit të qytetarëve në vendimmarrje; transparencës së institucioneve; rinisë dhe edukimit; rritjen e kualitetit të arsimit dhe zhdukjen e analfabetizmit; mbrojtjen e të drejtave të njeriut; zhdukjen e varfërisë; përmirësimin e jetesës dhe kualitetit të saj përmes projekteve sociale dhe edukative; mbrojtjen e mjedisit dhe edukimin e masave; zhvillimin ekonomik dhe punësimin.

Profili dhe kompetencat

Mileniumi i Ri ka filluar aktivitetet me grupe të rinjsh në çështje konkrete siç janë: Mjedisi, Edukimi dhe problemet sociale. Mbështetur nga donator të ndryshëm kemi punuar në fusha të ndryshme ndër to: Politikat publike, punësimi, qeverisja lokale, punësimi, forcimi i rolit të qytetarëve në vendimmarrje dhe përmirësimi i transparencës së institucioneve. Ne vazhdojmë të punojmë në fushat: qeverisja lokale, përmirësimi i kushteve për të rinjtë, edukimi dhe çështjet mjedisore.

Adresa

Dardania, Rruga: "Lekë Dukagjini" 10000,
Prishtinë, Republika e Kosovës
Telefon : +377 (0) 44 307 533 ; +386 (49) 245 285
E-mail : ojqmileniumiiri@yahoo.com
Website: www.ngo-newmillennium.yolasite.com

